



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2024:086185

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05489932

P.nr.59/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Lulzim Paçarizi, si dhe sekretaren juridike Behije Karaçica, në çështjen penale, të akuzuarit F. Xh., për shkak veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH-Gjakovë PP/II.nr.1264/23 të dt. 13.03.2024, me propozimin për dhënien e urdhrit ndëshkimor, jashtë seancës për shqyrtimin gjyqësor me dt.22.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-Gjakovë Gjakovë PP/II.nr.1264/23 të dt. 13.03.2024, ndërsa Gjykata, jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I AKUZUARI: F.A. Xh., lindur me dt...., në fshatin M. komuna e M., me nr personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se nga data e pavërtetuar e gjerë me datë 12.11.2022 në shtëpinë e tij saj në fshatin M. K-Malishevë, me qëllim që vetit t'i sjell përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme, ka shfrytëzuar energjinë në kundërshtim me Ligjin për Energji Elektrike të Republikës së Kosovës Nr.05/L-085, në atë mënyrë që gjatë kontrollës së realizuar nga punëtorët e K.-it në njehsorin elektrik me numër është konstatuar se i pandehuri kishte anashkaluar një prize trefazore jashtë matjes së njehsorit dhe me këtë veprim energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç'rast të dëmtuarës K.-distrikti në Gj. i ka shkaktuar dëm material.

- me këto veprime kanë kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata konform nenit 4, 7, 17, 38, 39, 40, 43, 69, dhe nenit 314 par.6 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 360, 364, 453, 462 dhe 495, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të njëjtëve u`a shqipton:

DËNIMIN ME GJOBË

Me dënimin me gjobë në shumën prej **200 €** (dyqind euro), të cilën shumë është i obliguar që ta paguaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën nëse dënimin e shqiptuar në të holla nuk e paguan në afatin e cekur. i njëjti do ti zëvendësohet me dënim burgim në kohëzgjatjen prej 10 ditësh, duke llogaritur çdo ditë të filluar burgimi nga 20 €.

Obligohet i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor, Gjykatës t'ia kompenzon shumën prej 20 € (njëzet) euro, për programin mbi kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 20 euro, ndërsa shpenzime të procedurës nuk ka pasur, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara K.- distrikti në Gj., lidhur me kërkesën pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civil.

A r s y e t i m

PTH-Gjakovë me aktakuzën PP/II. nr. 1264/23 të dt. 13.03.2024, me propozim për dhënien e urdhrit ndëshkimor, e ka akuzuar F. Xh., për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke i propozuar gjykatës që ta pranon kërkesën për urdhër ndëshkimor, më të cilin të akuzuarit t'i dënon me dënimin me gjobë.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes penale, vërtetoi se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 par.1 dhe neni 495 të KPPK së , e aprovoi propozimin e PTH-së për dhënien e urdhrit ndëshkimor, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Është vlerësim i gjykatës se provat që i janë të bashkangjitura propozimit për dhënien e urdhrit ndëshkimor, e të cilat gjinden në shkresat lëndës janë: Procesverbali mbi konstatimin e gjendjes faktike të njehsorit, nr.... dt.12.11.2022, fatura mbi kalkulimin e rikthimit të humbjeve me nr.D. dt.29.11.2022, fotografite e vendit të ngjarjes dhe shkresat tjera të lëndës, e që janë prova të besueshme dhe të mjaftueshme për ta shpallur fajtor të akuzuarin.

Vendimin mbi paushallin gjyqësor gjykata e mbështet në nenin 449 par.1 dhe 2 KPPK-së, ndërsa vendimin në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39 parg.3 nënpar. 3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha më lart u vendos si dispozitiv të këtij aktgjykimit e konform nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË DEGA MALISHEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.59/24 me dt.22.03.2024

Sekretarja juridike
Behije Karaçica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Lulzim Paçarizi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është i lejuar kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e pranimit të te njëjtit, kësaj Gjykate, në të kundërtën nëse i akuzuari nuk e ushtron kundërshtimin, aktgjykim do ta marr formën e prerë.